# Albina Spaha (Lako)

KRYETARE E GJYKATËS SË RRETHIT GJIROKASTËR

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




8.2 herë Rritja e Pasurisë Bruto

+ 1,304,095 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash




Pasuritë e Paluajtshme




Pasuritë e Luajtshme




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Paga dhe shpërblime nga funksioni | 14,838,025 | 41.4% |
| Paga e bashkëshortit | 18,296,540 | 51.0% |
| Të ardhura nga qeraja | 1,620,000 | 4.5% |
| Të ardhura nga interesat bankare | 473,255 | 1.3% |
| Dëmshpërblim për bashkëshortin nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar | 650,000 | 1.8% |
| Total | 35,877,820 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me probleme

13 Pa probleme

Subjekti rezulton me probleme mosjustifikimi të pasurisë në vitin 2007 në shumën 647,160 lekë (pa llogaritur shpenzimet e konsumit familjar), vit në të cilin deklaron shtim pasurie apartament banimi me vlerë 44,000 USD. Nuk ka të dhëna mbi burimin e krijimit.

Për vitin 2005, subjekti deklaron shtim të kursimeve familjare në masën 1,200,000 lekë, nga të cilat një pjesë e tyre është dhënë hua - nuk specifikohet sa është shuma e dhënë hua dhe për këtë arsye është trajtuar e gjithë vlera si gjendje cash.

Gjendja Cash që rezulton në fund të periudhës deklaruese është 5,557,000 lekë, disa herë më e lartë se kufiri i lejuar për t' u mbajtur Cash prej 1,500,000 lekë, sipas nenit 4/1 të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar.